



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Fjala e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu në Kuvend

2017-12-05 10:11:00



Fund dhunës ndaj grave dhe vajzave!
Fjala e Ministres së Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta
Manastirliu në Kuvend

**Të dashur qytetarë,
Të nderuar deputetë,**

Dhuna ndaj grave, dhuna në familje për
fat të keq nuk mund të zhduken as në
16, as në 60 dhe as në 365 ditë!
Hurma, Lumturi, Demirka, Natasha,
Jenie, Sosja, Firdesi, Dijsa, Migena, Vera
janë gratë që humbën jetën gjatë këtij
viti. Me humbjen e tyre, humbi familja,
humbi shoqëria!

Ndaj kërkohet akoma më shumë për të bërë që mos të ketë më
viktima të dhunës. Nuk do të doja kurrë të vija këtu për të folur për
jetë të humbura...por fatkeqësisht sot dhuna ndaj grave dhe dhuna
në familje është ende prezente në shoqërinë tonë siç është
prezente edhe në Botë. Çdo ditë e më shumë duhet të forcojmë
çdo mekanizëm parandalues dhe mekanizëm mbrojtës.

Të drejtat e grave janë pjesë integrale e të drejtave të njeriut dhe
Qeveria Shqiptare shpreh angazhimin e saj për t'i dhënë fund
dhunës ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje, bazuar në
Konventat e ratifikuara si Konventa e OKB për Eliminimin e të gjitha
formave të dhunës ndaj grave (CEDAW), protokolleve të saj apo
Konventën e Stambollit, të cilat që janë si udhërefyese kryesore për
harmonizimin e legjislacionit tonë kombëtar.

Në 24 Nëntor të këtij viti, Komiteti i ekspertëve të Këshillit të
Europës (GREVIO), ka publikuar Raportin e Parë për Shqipërinë,
ku përgëzon autoritetet shqiptare për masat legjislative dhe masat
rregullatore të ndërmarra deri më sot, por kërkon hapa të reja
shtesë për të trajtuar të gjitha format e dhunës ndaj grave.

Angazhimi i Qeverisë pasqyrohet qartazi në zbatimin e Strategjisë
Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020,
me synim përfshirjen e çështjeve gjinore dhe dhunës në familje në
politikën publike, nëpërmjet planeve konkrete të veprimit, të
detajuara dhe buxhetuara, për të hedhur bazat për avancimin e
barazisë gjinore dhe minimizimin e fenomenit të dhunës në familje
në të ardhmen, mbështetur në dokumentat, rekomandimet dhe
instrumentat ndërkombëtare.

Inisiativa e fundit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale është rishikimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në
marëdhëniet familjare". Nisur nga nevoja për harmonizimin e
legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian;
përputhshmëria me standartet e Konventave ndërkombëtare, por
për së pari, dhe mbi të gjitha, në përgjigje të rasteve të shtuara të
dhunës në familje, në disa raste me pasoja tragjike, rishikimi i këtij
ligji tashmë është domosdoshmëri.

Ne do të vijojmë punën në adresimin e barazisë gjinore dhe dhunës
me bazë gjinore dhe dhunës në familje, paralelisht me nismat që
synojnë rritjen e mirëqënies për gratë dhe vajzat në Shqipëri. Do të
vijojmë mbështetjen dhe forcimin e strehëzave për gratë dhe
viktimat e trafikimit si dhe ngritjen dhe mbështetjen e qendrave

sociale në bashkëpunim me pushtetin lokal dhe organizatat e shoqërisë civile.

Qeveria katër vitet e fundit ka mbështetur programet e nxitjes së punësimit të grave nga grupet e veçanta.

Duke njohur fuqinë e edukimit, kemi përfshirë më shumë vajza e gra në arsim dhe formim profesional, si një nga rrugët më të mira drejt punësimit të sigurtë.

Nëpërmjet programit të ndërmarrjeve sociale po synojmë promovimin e barazisë gjinore përsa i përket rritjes së mundësive në aksesimin e tregut të punës dhe nxitjen e frymës së përgjegjshmërisë shoqërore.

Me ngritjen e Urdhrit të Psikologut dhe shumë shpejt dhe të Urdhrit të Punonjësit Social, viktimave të dhunës ju jepet një ndihmë e specializuar për më shumë efikasitet në trajtimin e rasteve.

Sa i përket shërbimeve në territor, viktimave të dhunës ju ofrohen shërbime në familje, në Strehëzën Kombëtare si dhe ato rajonale.

Shërbimet e ofruara në Strehëzën Kombëtare për viktimat e dhunës në familje kanë ardhur duke u rritur dhe kjo duket dhe në numrin e grave të cilat janë riintegruar pas marrjes së këtyre shërbimeve në strehëz. Vetëm gjatë këtij viti kanë marrë shërbime në strehëz 35 gra, nga këto 30 janë të integruara. Po të bëjmë një krahasim me katër vite më parë është trefishuar numri i grave që janë riintegruar duke u punësuar.

Gjithashtu, një punë e konsiderueshme është bërë, duke miratuar standartet e ofrimit të shërbimit në lidhje me Linjës Kombëtare të Këshillimit për viktimat e dhunës.

Fuqizimi i mekanizmit kombëtar për barazinë gjinore është gjithashtu një objektivi i Qeverisë Shqiptare dhe një pjesë e rekomandimeve të vazhdueshme të dhëna në kuadrin e disa Konventave dhe integrimit të Shqipërisë në BE.

Faleminderit!